

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO rrëzon kërkesën e avokatëve për celularët: Rregullorja është e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procese gjyqësore
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/telefoni-nuk-eshte-studio-e-levizshme-gjkkko-nuk-terhiq-et-nga-ndalimi-i-telefonave-mund-te-perdorin-laptop-et/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 09:31:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 09:29:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 09:28:00 UTC → 17 shtator 2026, 09:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t'ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69fa2b01e3e776973088479bf76729111e2c3fa996677209eb2001cbebaed2b7
TEKSTI	b2bc67f53104c5826a3cd3d45130696f616fa007aaa123bb6f92629b4c110745
PAMJA	ed61da4315ee875234f5a1dfcf4d74f5154976e2ec1965e72c6610bec0f6fb91

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	01aaf61b6c387c6c92780c993e4bf68313188dc633401fb2d53c7cf0192e40ef
E MËPARSHMJA	49210b546db9814c4bfcba4a81da034a86d84b0bc2afeb42354de85de07dd98c3
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/01aaf61b6c387c6c92780c993e4bf68313188dc633401fb2d53c7cf0192e40ef>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

GJKKO rrëzon kërkesën e avokatëve për celularët: Rregullorja është e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procese gjyqësore

17/09/2026 11:29



Gjykata e Posaçme nuk tërhiqet nga rregullorja e re që kufizon mbajtjen dhe përdorimin e telefonave celularë në ambientet e saj.

Në një përgjigje të gjatë drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, pas kërkesës së kësaj të fundit për rishikimin e nenit 76, GJKKO argumenton se kufizimi është i ligjshëm, proporcional dhe nuk cenon ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes.

Me hyrjen në fuqi të rregullores së re më 1 shtator, kreu i Dhomës së Avokatisë iu drejtua GJKKO-së me një kërkesë për rishikimin e saj.

Gjykata e Posaçme në përgjigjen dërguar avokatëve, thekson se rregullorja duhet të zbatohet për sa kohë është në fuqi. Nëse Dhoma e Avokatisë e kundërshton atë, sipas GJKKO-së, duhet të ndjekë rrugët ligjore pranë organeve kompetente.

"GJKKO-ja sqaron se Rregullorja ka hyrë në fuqi më datë 01.09.2026 dhe se, si akt i miratuar sipas procedurës së parashikuar dhe në fuqi, ajo është e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin gjyqësor. Për rrjedhojë, GJKKO-ja kërkon nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë zbatimin e plotë të saj, përfshirë nenin 76. Në rast se Dhoma e Avokatisë vijon ta kontestojë këtë rregullim, ajo ka në dispozicion rrugët ligjore përkatëse për ta kundërshtuar atë përpara organeve kompetente; ndërkohë, kontestimi nuk e pezullon efektin juridik të Rregullores dhe nuk mund të shërbejë si shkak për mospjesëmarrje në seancat gjyqësore", thuhet në përgjigjen e GJKKO-së.

Për të mbështetur qëndrimin e saj, GJKKO sjell në përgjigjen e saj prej 21 faqesh një sërë referencash nga praktika shqiptare dhe ndërkombëtare, duke krahasuar kufizimet e vendosura në Gjykatën e Posaçme me rregullat që zbatohen në gjykata të tjera.

Një prej referencave është vetë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. GJKKO citon rregulloren e Kushtetueses, sipas së cilës në sallën e gjykimit ndalohet përdorimi i kompjuterit portativ gjatë seancës, ndërsa regjistrimi radiofonik, televiziv, audio apo video lejohet vetëm me pëlqimin e Gjykatës. Sipas argumentimit të GJKKO-së, kjo tregon se edhe një gjykatë tjetër shqiptare vendos kufizime mbi pajisjet elektronike gjatë zhvillimit të seancave.

Në përgjigjen prej 21 faqesh sillet edhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. GJKKO argumenton se edhe GJEDNJ-ja ka rregulla për pajisjet elektronike dhe regjistrimin brenda ambienteve të saj.

Por krahasimet shkojnë edhe përtej Europës. GJKKO i referohet praktikës së gjykatave federale në Shtetet e Bashkuara, ku, sipas dokumentit, mund të ndalohet përdorimi i telefonave celularë dhe pajisjeve elektronike në godina gjykatash, konkretisht Gjykata Federale e Distriktit Verior të Iowa-s.

I Kryesore



UÇK i bën bashkë të gjithë në Parlament, Kuvendi i Shqipërisë del me deklaratë të përbashkët: Nuk mund të barazohet agresori me viktimën

15:15

Ekskluzive/ Poezi imagjinare me nënën, si Jakup Krasniqi i jepte vetes zemër në paraburgim

11:39

Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

14:16

SHBA rrit normat e interesit/ Rezerva Federale sfidon presionin e Trump: Inflacioni mbetet shumë i lartë

12:58

Kombëtarja shqiptare nis rrugëtimin e Nations League, të shtunën Maran publikon listën e të përzgjedhurve

12:35

I Më të lexuarat

E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime"/ Vendimi për liderët e UÇK-së, avokatja përletot në 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studio' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, Paskal Milo: Specialja u ngrit nën presionin e SHBA dhe BE, vendimi i sotëm është rrjedhojë e një kalkulimi gjeopolitik për të afruar Serbinë me Perëndimin

Gjykata e Hagës dënoi me 25 vite burg Hashim Thaçin, reagon djali i ish-liderit të UÇK: Ne e dimë historinë, ushtarët tanë e kanë të gdhendur në lëkurë

Deputetët në seancë plenare. Përshkallëzon tubimi jashtë Kuvendit, protestuesit godasin me vezë dhe bllokojnë rrugën. Shoqërohet Dritan Goxhaj dhe disa të tjerë

Inside Story/ Video ekskluzive nga momentet e tmerrit, kamioni zë poshtë


Gjykata sjell më tej shembullin e Gjermanisë, ku, sipas gjykatat mund të vendosin kontrollin mbi pajisjet elektronike në funksion të sigurisë dhe zhvillimit të rregullt të procesit.

Për Francën përmendet neni 38 i ligjit të vitit 1881, që lidhet me ndalimin e regjistrimit dhe transmetimit gjatë seancave gjyqësore, ndërsa për Italinë referohet neni 147 i dispozitave zbatuese të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit *"filmimi dhe fotografimi në sallë lidhen me autorizimin e posaçëm të gjykatës"*.

Në listën e praktikave krahasuese përfshihen edhe Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda. GJKKO i përdor këto raste për të argumentuar se administrimi dhe kufizimi i pajisjeve elektronike në gjykata nuk është një praktikë vetëm shqiptare, por gjendet, me forma dhe shkallë të ndryshme, edhe në sisteme të tjera gjyqësore.

Sipas GJKKO, celulari u është ndaluar të gjithë pjesëmarrësve në procesin gjyqësor.

Në pikën 69 të përgjigjes së saj për kreun e Dhomës së Avokatisë. Gjykata e Posaçme thekson se *"Rregullorja është e detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin gjyqësor"*.




Top Channel

I Aktualitet »



Daja e deputetes së PS e rrahu dhe plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjine Çaushtit: Ja si qëndron e vërteta

17/09 15:42



Sa paguhen sot magistratët? Kërkesa për rritje me 43%, pagat e gjyqtarëve ndezin debat institucional

17/09 15:18



Falsifikim dokumentesh për ndryshimin e emrit, pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim dhe një 41-vjeçar

17/09 14:47



Kundërshtoi pezullimin e afateve të paraburgimit, Apeli rrëzon kërkesën e ish-presidentit Meta

17/09 14:25



Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

17/09 14:16



Autor i 16 vjedhjeve në lokalet e kryeqytetit, arrestohet 34-vjeçari, kishte thyer masën e sigurisë "arrest në shtëpi"

17/09 13:55

I Kryesore »



kalimtarin në rrugë, shoferi largohet dhe...

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente të falsifikuar/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe përfituesi

Publikohen fotot e dëmeve nga sulmet iraniane në bazat amerikane, avionë të dëmtuar dhe infrastrukturë e shkatërruar në Lindjen e Mesme

Alarm në Gjermani, "plas" malaria e aeroportit, 8 të prekur e dy viktima në Frankfurt



Nga polemikat me fanellën te Lamine Yamal, rrefehet Kylian Mbappe: Ky është viti, Topi i Artë duhet të kthehet në Bernabeu

17/09 15:42



Daja e deputetes së PS e rrahu dhe plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjine Çaushtit: Ja si qëndron e vërteta

17/09 15:42



Sa paguhen sot magjistratët? Kërkesa për rritje me 43%, pagat e gjyqtarëve ndezin debat institucional

17/09 15:18



UÇK i bën bashkë të gjithë në Parlament, Kuvendi i Shqipërisë del me deklaratë të përbashkët: Nuk mund të barazohet agresori me viktimën

17/09 15:15



"S'mund të heshtim, Shqipëria e Kosova të bashkohen në një përpjekje institucionale për drejtësinë"/ Spiropali: Çfarë duhet të ndodhë që të bashkohemi të gjithë

17/09 15:13



Alarmoi policinë për bombë në shkollën "Emin Duraku", "detyrim paraqitje" për Mandi Jataganin: Do ta bëj sërish nëse...

17/09 14:16

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ Bedri Hamza paralajmëron hapa ligjorë pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së në Hagë



Top Channel/ UÇK na bashkon! Kuvendi i Shqipërisë: S' mund të barazohet agresori me viktimën



Top News – BE dhe Kanadaja, më të forta bashkë! Carney i përgjigjet Trump: Nuk po kërkojmë dominim



Top Channel/ Shtatorja e Teutës ilire në Lezhë. Nismë e gazetarit të Top Channel, Marin Mema



Top Channel/ Ministrja e re e Shëndetësisë i përgjigjet opozitës për çështjen e fondeve të dializës



Top News – Tmerri i lokaleve të Tiranës. Grabiti 16 prej tyre në 6 javë, arrestohet nga policia

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tanil!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.